

RADIO KLAN

Rr. Aleksander Moisiu
Ish – Kinostudio
Tirane – Shqiperi
Tel: +355 4 2347805/6/7

VENDIM

I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE RADIO KLAN SH.P.K

“Per shnderrimin e formes ligjore te shoqerise”

NR. 2 Date 23 / 05 / 2020

Sot, me 23 / 05 / 2020, ne oren 11:00, ne seline e Shoqerise “Radio Klan” sh.p.k, ne Rrugen: “Aleksander Moisiu”, Ish-Kinostudio, Tirane u hartua ky vendim i ortakut te vetem te shoqerise, ne zbatim te nenit 81/1 gj, 228 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqerite tregtare” (i ndryshuar).

Ortaku i vetem i kesaj shoqerie, ne perputhje me percaktimet e nenit 228 te Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”(te ndryshuar),

VENDOSI:


1. Miratimin e raportit te Administratorit per shnderrimin e formes se shoqerise.
2. Ndryshimin e formes ligjore te shoqeri se “Radio Klan” sh.p.k nepermjet shnderrimit si vijon:
 - Shoqeria “Radio Klan” deri tani shoqeri me pergjegjesi te kufizuar shnderrohet ne Radio Klan Shoqeri Aksionare me oferte private sipas nenit 105 te Ligjit Tregtar.
3. Shnderrimi i formes ligjore te shoqerise nuk sjell asnje pasoje ne ndryshimin e te drejtave dhe detyrimeve te vecanta te Ortakut te Vetem qe kalon ne Aksionar te Vetem dhe miraton kete shnderrim.
4. Miratimin e Statutit te shoqerise Radio Klan SH.A.
5. Ngarkohet Administratori (dhe cdo person tjeter i autorizuar nga ky i fundit) te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme per depozitim ne Q.K.B te ketij vendimi dhe regjistrimin e shnderrimit te formes ligjore te shoqerise.

ORTAKU I VETEM

I

SHOQERISE “RADIO KLAN” SH.P.K

PAL TOMA



PROCESVERBAL I ASAMBLESE SE PERGJTIHSHME TE ORTAKUT TE VETEM "Per shnderrimin e formes ligjore te shoqerise"

Sot, me 29/05/2020, ne oren 11:00, ne seline e Shoqerise "Radio Klan" sh.p.k, ne Rrugen: "Aleksander Moisiu", Ish-Kinostudio, Tirane u mbajt ky procesverbal i ortakut te vetem te shoqerise, ne zbatim te nenit 228 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar).

Ortaku i vetem i kesaj shoqerie, ne perputhje me percaktimet e nenit 228 te Ligjit nr.9901, date 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"(te ndryshuar),

VENDOSI:


1. Miratimi e raportit te Administratorit per shnderrimin e formes se shoqerise.
2. Ndryshimin e formes ligjore te shoqeri se "Radio Klan" sh.p.k nepermjet shnderrimit si vijon:
 - Shoqeria "Radio Klan" deri tani shoqeri me pergjegjesi te kufizuar shnderrohet ne Radio Klan Shoqeri Aksionare me oferte private sipas nenit 105 te Ligjit Tregtar
3. Shnderrimi i formes ligjore te shoqerise nuk sjell asnje pasoje ne ndryshimin e te drejtave dhe detyrimeve te vecanta te Ortakut te Vetem qe kalon ne Aksionar te Vetem dhe miraton kete shnderrim.
4. Miratimin e Statutit te shoqerise Radio Klan SH.A.
5. Hartimit te Vendimit te OrtakuT te Vetem per shnderrimin e formes ligjore te shoqerise.
6. Ngarkohet Administratori (dhe cdo person tjeter i autorizuar nga ky i fundit) te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme per depozitimin ne Q.K.B te ketij procesverbalit.

ORTAKU I VETEM

I

SHOQERISE "RADIO KLAN" SH.P.K

PAL TOMA



Mbajtesi i Procesverbalit

Blerina SATA



Administrator



RAPORT I ADMINISTRATORIT

"per shderrimin e formes se shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri aksionare"

Baza Ligjore: Ne zbatim te nenit 229 pika 1 te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar) hartohet raporti si vijon per shderrimin e formes ligjore te shoqerise "Radio Klan" nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe shoqeri aksionare me oferte private.

Baza ekonomike: Shoqeria I ka mundesite ekonomike per te kryer kalimin nga **shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri aksionare** duke plotesuar dhe tejkaluar kufirin e kapitalit themeltar te nje shoqerie aksionare qe sipas ligjor eshte **3.500.000 leke**. Aktualisht, kapitali themeltar i shoqerise eshte 13.000.000 leke.


Veshtiresi te vecanta te vleresimit: Hartimi i ketij raporti nuk paraqet veshtiresi per shkak se shoqeria eshte krijuar ne vitin 2009 dhe gezon aktualisht nje licence rajonale te transmetimit audio duke mbuluar 4 qarqe ne Shqiperi, perkatesisht: Tirane, Durres, Vlore, Fier.

Per shkak te nevojave te shoqerise per te zgjedhurar zonen e licencimit te saj si dhe per te garuar ne garen e celur nga organi kompetent (Autoriteti i Mediave Audiovizive) per marrjen e licences kombetare audio, kerkese e se ciles eshte qe shoqeria te jete aksionare, kryhet ky shderrim i formes se shoqerise, me vullnetin e plote te te dy Ortakeve te shoqerise te cilet do te firmosin vendimin perkates sipas kerkesave ligjore.

Efekti i shderrimit te shoqerise tek punonjesit: Shderrimi i formes ligjore te shoqerise nuk do te sjelle asnje efekt negativ tek punonjesit aktual te shoqerise, perkundrazi pritet rritje e numrit te te punesuarve ne shoqeri para aplikimit per licencim por edhe pas marrjes se licences.

Shoqeria "Radio Klan" sh.p.k

Blerina SATA


Administrator

